

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magjistratëve, thirren në komision institucionet e drejtësisë! KLP-GJL kundër formulës së PS, i b ashkohet PD
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/15/pagat-e-magjistratave-thirren-ne-komision-institucione-t-e-drejtësisë-klp-gjl-kunder-formules-se-ps-i-bashkohet-pd/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:39:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:38:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	37526864075ad73bc6e0bfe7db7d5c03c8cf892af29f15f79bc4e45ecf7d5b5a
TEKSTI	d3a0afc383a27ac09f49b750a3c6e56716b6bf9efdc9524deb07cbf752ddfd35
PAMJA	2987e76416be6a20e9281fcca5c311b6eb1a6ade37720e8aa599cec9c6cb73eb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	67be1a60c0b840c69579073daa59f40f58a1345d8ab2a2c3d23e95090850d8c8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/67be1a60c0b840c69579073daa59f40f58a1345d8ab2a2c3d23e95090850d8c8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pagat e magistratëve, thirren në komision institucionet e drejtësisë! KLP-GJL kundër formulës së PS, i bashkohet PD

Aktualitet

Publikuar: 15/09/2026



Në Komisionet parlamentare vijon diskutimi i projektligjit të socialistëve për pagat e magistratëve, ku janë thirrur për seanca dëgjimore drejtues të institucioneve të drejtësisë. KLGJ, KLP, Gjykata e Lartë e institucione të tjera e kundërshtojnë propozimin e mazhorancës, pasi sipas tyre e shkel vendimin e Kushtetueses. *“Nuk jemi njohur me detaje, por rritja është minimale, ka një diferencë të madhe me vendimin tonë, nuk reflekton standardin e vendosur nga gjykata kushtetuese”, tha kryetarja e KLP Mirela Bogdani.*

‘Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, jo orientim, por detyrim, ka caktuar detyrimin dhe afatin, e më tej pasojat. Gjykata e Lartë nuk kundërshton në parim që ligjvënësi të propozojë një referencë të re, por ajo që keni propozuar ju, nuk e realizon plotësisht standardin e vendosur nga gjk, ne propozojmë një mekanizëm që sjell respektimin real të Gjykatës Kushtetuese’, tha zv. kryetari i Gjykatës së Lartë Ilir Panda, në komisionin e ligjeve.

Qëndrimin të tyre i është bashkuar edhe Partia Demokratike. Nismë antikushtetuese të Partisë Socialiste e quajti kreu i grupit të PD, Gazment Bardhi, teksa foli në komisionin e të Drejtave të Njeriut.

“Me këtë ligj që keni sjellë ju, do të vijmë prapë këtu, sepse ligji do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese dhe do ta rrëzojë sërish atë. Sepse ky propozim është në shkellje të hapur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm duke mos e reflektuar atë, por duke bërë të kundërtën e asaj që kërkohet. Kur kemi bërë reformën në drejtësi, kemi qenë të qartë se duhet t’i kthejmë integritetin gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ne nuk mund t’i trajtojmë sot si lëmoshë. Në fund fare, ne duhet t’i trajtojmë ata

Me të lexuarat

Bosi i Lurrës
hap kartel kompanish dhe fondacionesh. A po pastron në ndërtim
PAMF-Bod e mashtrore...
Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg
Nikamë blinte të njëjtin buzëkuq çdo të premtë:
Punonjësja u përlot kur
Kryetari i IUT zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve
Partia Demokratike heqjen e imunitetit të deputetit socialist të PASOK-ut, Niko...

minimalisht si veten.

Ne ia rritëm rrogën vetes pak vite më parë me rreth 50%, kryeministrit me më shumë se 60%, ministrave me më shumë se 60%. Ne na paguhet nafta, telefoni dhe gjithçka tjetër. Nuk mund të bëhet krahasim me deputetët apo ministrat. Po, një gjyqtar duhet ta kalojë edhe deputetin, edhe ministrin, edhe presidentin. Çfarë bën Bajram Begaj që rri kot në zyrë dhe nuk mund të marrëka më shumë një magjistrat? Janë këta gjyqtarë që janë përballë krimit dhe japin dënime me burgim të përjetshëm. Prandaj meritojnë integritet dhe, e përsëris, nuk mund t'i trajtojmë për lëmoshë.”, tha Bardhi.

Qeveria, përmes ministrit të Drejtësisë Toni Gogu, i cili kritikoi Kuvendin për vonesën, tha se drafti zgjidh situatën.

“Është një çështje shumë e rëndësishme. Kuvendi e humbi afatin e 31 korrikut, kjo është një gjë që nuk ka nevojë të justifikohemi. Bylykbashi ngriti disa pikëpyetje për rolin ligjvënës, dhe ne jemi të hapur për përgjegjësinë që na takon për këtë proces.

Dua të them një gjë shkoqur, nuk besoj se vonesa e Kuvendit të sillte përplasje mes pushteteve. Edhe projektligji që vjen bën pikërisht këtë gjë, një ndreqje të një gabimi që është bërë. Thelbi është te pyetja se kush duhet të vendosë për pagat? Dhe këtë e thotë vetë Gjykata Kushtetuese, që e vendos vetë Kuvendi dhe e vendos me ligj”, tha Gogu.

Ashtu siç kishte paralajmëruar, mazhoranca po shkon drejt miratimit të një formule për pagat e magjistrave në seancën e ardhshme, më 17 shtator. Në komisione parlamentare ka nisur diskutimi i projektligjit të propozuar nga socialistët, që paga referuese e magjistratëve të rritet nga 36 në 38% të pagës së Presidentit të Republikës.

Pritet që të jetë pikërisht ky propozim që do të miratohet, me qeverinë që ka dhënë dakordësinë përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave. Drafti i PS parashikon një rritje me rreth 8500 lekë për rrogën referuese të magjistratëve, ndërkohë që pretendimi i tyre, i miratuar edhe nga KLGJ e KLP, është 9-fish më i lartë, rreth 80 mijë lekë më e lartë.

Report Tv ka siguruar edhe mendimin zyrtar që Këshilli i Ministrave i ka dërguar Kuvendit. Qeveria përlllogarit rreth 1.5 miliardë lekë detyrime të prapambetura nga prilli 2023, periudhë nga e cila Kushtetuesja kërkon efektet financiare. Për shkak të koston, propozon që shuma të mos paguhet menjëherë, por me këste brenda dy viteve.

TAG:

Institucionet e drejtësisë

Pagat e magjistratëve

Të ngjashme





Erion Veliaj mbeti në burg, reagon avokati mbrojtës: Vendimi ngre pikëpyetje për garancitë kushtetuese



Cënuan perimetrin e sigurisë në shkollë gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë



Balla sulmon opozitën: Manipuloi me videon e nxënësve në Tuz për propagandë politike

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION **DOSJE ROZË**

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.